



A.nr. 539/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.539/2026, të datës 14.05.2026, të parashtruar nga ankuesja Sh.H M, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.539/2026, e datës 14.05.2026, e parashtruar nga ankuesja Sh.H M.

A r s y e t i m

Ankuesja Sh.H M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*) më datë 14.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Agjencisë Pyjore të Kosovës, lidhur me mos kompensimin e shtesës sipas nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 18.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Agjencia Pyjore e Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 20.05.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova:Ankesën me numër protokolli 2302/2026 të datës 14.05.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensim për ankuesen nga Shefi për Buxhet dhe Financa i MBPZHR për Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Marrëveshjen e datës 20.02.2024 e lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë Pyjore e Kosovës; Akt Emërimit AE.Nr.1/2022 të datës 05.07.2022; Kërkesë për qasje në SIMFK për vitin 2024 datë 20.02.2024 nga Sekretarja e Përgjithshme e MBPZHR për Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit; Listën për qasje të përdoruesve në

SIMFK datë 20.02.2024; Emailin e datës 26.02.2024 nga ankuesja; Emailin e datës 23.02.2024 nga M.D-H për ankuesen; Emailin e datës 27.02.2024 nga ankuesja për Z.I; Emailin e datës 27.02.2024 nga Z.I për ankuesen; Raportin detaj i Buxhetit për vitin 2024; Raportin e planifikimit të keshit për vitin fiskal 2024; Emailin e datës 23.04.2024 nga ankuesja për R.Sh; Emailin e datës 17.04.2024 nga R.Sh për ankuesen; Emailin e datës 21.05.2024 nga ankuesja për R.Sh; Emailin e datës 20.05.2024 nga R.Sh për ankuesen; Raportin përmbledhjes i kontrollit të buxhetit vitit fiskal 2024; Emailin e datës 16.12.2024 nga V.Ç për ankuesen; Emailin e datës 16.12.2024 nga M.V për V.Ç, F.A, N.T; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigjen në ankesë e datë 18.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 20.05.2026; Emailin e datës 20.05.2026 nga Z.I për D.G.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se, ankuesja sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.1/2022 të datës 05.07.2022 është e punësuar në pozitën *Zyrtare për Buxhet dhe Financa* në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Tutje sipas shkresave të lëndës, më datë 20.02.2024 është nënshkruar marrëveshje mes zv. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe u.d Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, është nënshkruar Marrëveshja për ndarjen e shërbimeve të vetme për Zyrtare për Buxhet dhe Finance përkatësisht në Modulin për Menaxhim të Parasë së Gatshme në Agjencinë Pyjore të Kosovës, e ku sipas kësaj marrëveshje ankuesja ka qenë e angazhuar, për tërë vitin fiskal 2024.

Shefi për Buxhet dhe Financa, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 25.02.2026, ka parashtruar kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, nga i cili ka kërkuar që ankuesja të kompensohet me 20% të pagës për periudhën e angazhuar sipas Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë, mirëpo nuk ka marr përgjigje për këtë çështje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë vitit fiskal 2024, ka kryer detyrat në Menaxhimin e parasë së Gatshme në Agjencinë Pyjore të Kosovës sipas marrëveshjes se lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës, mirëpo nuk është kompensuar sipas dispozitave ligjore. Kërkon që ankesa të aprovohet, të detyrohet Agjencia Pyjore e Kosovës që në bazë të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë të bëjë kompensimin në masën prej 20% të pagës bazë për periudhën e angazhimit.

Kolegji i Këshillit, fillimisht konstaton faktin se Agjencia Pyjore e Kosovës, është Agjenci Ekzekutive, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore e Kosovës, përmes zyrtarëve kryesor administrativ, më datë 20.02.2024, kanë nënshkruar marrëveshje për ndarjen e shërbimeve të vetme për Zyrtare për Buxhet dhe Finance përkatësisht në Modulin për Menaxhim të Parasë së Gatshme në Agjencinë Pyjore të Kosovës, e ku sipas kësaj marrëveshje ankuesja ka qenë e angazhuar, për tërë vitin fiskal 2024, e që sipas Kolegjit të Këshillit, kjo marrëveshje ka karakterin e bashkëpunimit siç parashihet me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizmin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të

Pavarura, ku përcaktohet: *“1. Marrëveshja e shërbimit mund të bëhet për të rritur efikasitetin e kryerjes të shërbimeve të menaxhimit të përgjithshëm, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të auditimit të brendshëm për institucionet e administratës shtetërore. 2. Marrëveshja e shërbimit mund të bazohet në njërën nga skemat në vijim: 2.1. ministria amë iu ofron shërbime mbështetëse administratave të agjencive; 2.2. një agjenci iu ofron shërbime mbështetëse agjencive të tjera pas miratimit të ministrive të tyre amë”, mirëpo sipas kësaj marrëveshje nuk është paraparë asnjë mënyrë e financimit të shërbimit apo kompensimit për ankuesen për shërbimin e kryer.*

Duke marr parasysh pretendimin e ankueses për kompensim të vlerës prej 20% të pagës bazë për kohën e angazhimit në kuptim të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë, atëherë Kolegji i Këshillit, ju referuar Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publikë, gjegjësisht: Nenit 13, i cili përcakton: *“Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji, Nenit 22 paragrafi 1, i cili përcakton: “1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale, Nenit 28 ku përcaktohet se: “1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve/ve civil, apo pozitive të paplotësuarra për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar”.*

Po ashtu për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen, Kolegji i Këshillit ju referua edhe Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, gjegjësisht nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, ku parashihet se: *“1. Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunëseve civil, apo pozitive të paplotësuarra për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Shtesa për vëllimin e punës përfitohet nga nëpunësit civil, për punën e kryer për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj”, dhe nenit 9 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: “1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njesisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit”.*

Referuar bazës ligjore si më sipër, Kolegji i Kwshillit thekson faktin se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ka hyrë në fuqi më datë 05.02.2023, ndërsa, Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ka hyrë në fuqi më datë 06.02.2023, andaj, duke marr parasysh periudhën kohore për të cilën ankuesja pretendon se ka qenë e angazhuar edhe në Agjencinë Pyjore të Kosovës, sipas provave materiale nuk ka gjetur dëshmi që vërtetojnë faktin që lidhur me ushtrimin e punëve shtesë nga ankuesja të jetë lidhur marrëveshje mes ankueses dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ pra mes ankueses dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës, si një nga parakushtet kryesore për kompensim të shtresës për vëllim në punë, por ka vetëm marrëveshje mes institucioneve përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës ku nuk është paraparë asnjë lloj kompensimi, ndërsa nëse i referohemi Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit, konstaton se marrëveshja lidhet për një periudhë që nuk tejkalon një vit dhe e njëjta nuk mund të lidhet për periudhën retroaktive, pra për me tepër, referuar provave materiale të lëndës, ankuesja nuk ka ofruar dëshmi që vërtetojnë faktin që e njëjta gjatë periudhës së angazhimit kishte parashtruar kërkesë apo mjet të rregullt juridik në drejtim të realizimit të kompensimit të pretenduar si në ankesë, kështu që, përfundimisht Kolegji i Këshillit vlerëson se në mungesë të marrëveshjes së nënshkruar mes ankueses dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës, për shtesë për vëllim në punë, atëherë edhe kompensimi sipas nenit 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, nuk mund të realizohet.

Për sa më sipër, e duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.539/2026, datë 22/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses Sh.H M;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Drejtorit Ekzekutiv dhe Njesisë për Burime Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së